

996/997 p – SHKALLA E DISPONUESHMËRISË

Njësisë i vendoset e dhëna për shkallën e disponueshmërisë për të paralajmëruar huazuesin për kufizimet e caktuara, që vlejné për atë botim në procesin e huazimit (p.sh. mund të huazohet për një afat shumë të shkurtër, mund të huazohet vetëm nëse plotësohen kushtet e përcaktuara, nuk mund të huazohet fare etj.).

E dhëna është njëra nga kushtet që duhet të plotësohet në algoritmin e plotësimit të nënfushës 998c në nivelin e përbashkët dhe ndikon në shfaqjen e të dhënave për disponueshmërinë e koleksioneve në COBISS+.

E dhëna për kufizimin e disponueshmërisë rregullohet përmes listës së unifikuar të kodeve:

1	<i>kufizimi kohor i disponueshmërisë – deri 7 ditë</i>
2	<i>kufizimi kohor i disponueshmërisë – 7 ditë</i>
3	<i>kufizimi kohor i disponueshmërisë – 14 ditë</i>
4	<i>kufizimi i disponueshmërisë – sallë e leximit</i>
5	<i>kufizimi i disponueshmërisë – me leje të autorit</i>
6	<i>përmbajtja e dokumentit e padisponueshme (tretman i veçantë)</i>
7	<i>padisponueshmëri e plotë (kopje arkivi)</i>
8	<i>huazimi përmes libromatit nuk është i mundur.</i>

Afatet e "zakonshme" të huazimit, të cilat vlejné për llojet e veçanta të materialeve (p.sh. për monografitë afati i huazimit është 1 muaj, për seriale 14 ditë etj.), përcaktohen në modulin COBISS/Huazimi. Nëse moduli COBISS/Huazimi nuk është ende i instaluar, këto afate të huazimit mund të përcaktohen duke përzgjedhur alternativën 7. *Funksionet e veçanta* në menunë bazë të sistemit COBISS.

Kufizimi kohor i disponueshmërisë, kodet "1", "2" ose "3" vendoset vetëm tek ato kopje, të cilat nuk kanë afat të "zakonshëm" të huazimit. Nëse p.sh. në kuadër të monografive afati i huazimit të teksteve mësimore është ndryshe (p.sh. vetëm 14 ditë) nga afati i huazimit të librave nga beletristika (për të cilat afati i huazimit është p.sh. 1 muaj), nënfusha 996p do të plotësohet vetëm për tekstet mësimore (nëse huazohen për 14 ditë, përzgjidhet kodi "3").

Në modulin COBISS/Huazimi ekziston mundësia e rregullimit të parametrave në atë mënyrë që kontrolli i disponueshmërisë të përjashtohet (në këtë mënyrë p.sh. botimi, i cili në nënfushën 996/997p ka vlerën "6", pavarësisht kësaj huazohet etj.).

Elementet & gjatësia

Nënfusha nuk ka elemente.

SHEMBUJ

1.

996	□1	df2\ <i>n</i> 1223 f019910805
996	□1	df2\ <i>n</i> 1223\da f019910806 p7 (Kopja e parë nuk ka asnjë kufizim në huazim, për këtë arsye nënfusha 996p nuk ndodhet; tek kopja e dytë është vendosur numri "7", për t'i treguar përdoruesit se kjo kopje ka kufizime në huazim.)